

Taksat Mjedisore

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitura statistikore	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
1.3. Personi i kontaktit	Etis Jareci
1.4. Funksioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	ejareci@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	16.07.2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	16.07.2021
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	16.07.2021
3. Paraqitura statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Të dhënat paraqesin të ardhurat nga taksat mjedisore (sipas kategorisë së taksave - energjia, transporti, ndotja dhe taksat e burimeve) të ndara sipas aktivitetit ekonomik (paguesi i taksave), duke përdorur klasifikimin NVE për aktivitetet e prodhimit të zgjeruara për të mbuluar taksat e pagueshme nga familjet dhe jorezidentët.</p> <p>Taksat mjedisore konsiderohen si një instrument ekonomik për të kontrolluar ndotjen dhe menaxhimin e burimeve natyore dhe ato janë konceptuar për të ndikuar në sjelljen e bizneseve, prodhuesve dhe konsumatoreve. Taksat mjedisore janë pjesë e llogarive ekonomike në mjedis, pjesë e një sistemi satelitor të llogarive kombëtare.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Të ardhurat nga taksat mjedisore ndahen nga:</p> <p>A. Iloji i taksës mjedisore,</p>

	<p>B. sektori / industria e paguesit të taksave</p> <p>A. Klasifikimi sipas llojit të taksës mjedisore</p> <p>Për qëllime analitike, taksat e mjedisit ndahen në katër kategori:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. taksat e energjisë (përfshirë taksat e CO2), 2. taksat e transportit 3. taksat e ndotjes 4. taksat e burimeve natyrore (duke përjashtuar taksat për nxjerrjen e naftës dhe gazit). <p>B. Taksat mjedisore sipas veprimitarisë ekonomike</p> <p>Të ardhurat nga taksat mjedisore ndahen për paguesit e ndryshëm të taksave:</p> <ul style="list-style-type: none"> • sipas aktivitetit ekonomik sipas klasifikimit statistikor të aktiviteteve ekonomike në Komunitetin Evropian (NVE Rev.2) • familjet si konsumatorë • jorezidentë • nuk ndahet (e pamundur të ndahet në një nga kategoritë e përmendura më lart)
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Taksat mjedisore sipas të dhënave të aktivitetit ekonomik mbulojnë taksat e pagueshme nga të gjithë sektorët e ekonomisë: prodhuesit (aktivitetet ekonomike nga NVE), familjet si konsumatorë si dhe jorezidentët.</p>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Statistikat e taksave mjedisore përpilohen bazuar në 'Taksat mjedisore - një udhëzues statistikor' të Eurostat 2013.</p> <p>Taksa mjedisore: Taksa mjedisore përcaktohet si "Një taksë baza e të cilave është një njësi fizike (ose një përfaqësues i një njësie fizike) të diçkaje që ka një efekt negativ të provuar, specifik në mënyrë, dhe që identifikohet në ESA2010 si takse".</p> <p>Statistikat e taksave mjedisore janë pjesë e llogarive ekonomike mjedisore evropiane, të cilat përbëjnë llogari satelitore në llogaritë kombëtare. Kështu, statistikat e taksave mjedisore ndjekin përcaktimin ESA2010 të taksave'. Si pasojë, vetëm pagesat që identifikohen si taksa në llogaritë kombëtare mund të raportohen si taksa mjedisore ndërsa llojet e tjera të pagesave për qeverinë nuk përjashtohen nga fusha e mbledhjes së të dhënave. Pajtueshmëria me përkufizimin e taksave të llogarive kombëtare përmirëson krahasueshmërinë ndërkombëtare të statistikave dhe është në përputhje me udhëzimet, konceptet dhe përkufizimet e Sistemit të Llogaritjes mjedisore dhe ekonomike (SEEA). Lista kombëtare e taksave paraqet pikënisje për vlerësimin e të ardhurave nga taksat mjedisore. Metodologjia e përdorur për llogaritjen e tyre është bërë në përputhje me Rregulloren (BE) Nr 691/2011 dhe udhëzimet e Eurostat: "Taksat mjedisore, një udhëzues statistikor". Këto të dhëna janë të harmonizuara me Sistemin Evropian të Llogarive Ekonomike (ESA 2010).</p> <p>Taksat e energjisë: Taksat e energjisë (duke përfshirë karburantin e makinave) përfshijnë taksat mbi prodhimet e energjisë në vend, si dhe prodhimet e energjisë që përdoren edhe për qëllime të transportit. Këtu përfshihen edhe tatimet mbi bio-karburantet dhe format e tjera të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe taksat mbi rezervat e produkteve të energjisë.</p> <p>Taksat e Transportit: Taksat e transportit (me përfshirë karburantin e makinave) i referohen kryesisht taksave të lidhura me pronësinë dhe përdorimin e automjeteve. Këto taksa përfshijnë edhe taksat mbi mjetet e tjera të transportit (si avionët, anijet dhe trenat, etj) dhe shërbimet e tyre.</p>

	<p>Taksat e Ndotjes: Taksat e ndotjes përfshijnë emetimet e matura në ajër dhe shkarkimet në ujë, menaxhim të mbetjeve të ngurta dhe zhurmës etj. Përjashtohen këtu tatimi mbi emetimin e CO₂, i cili mbulohet nga kategoria taksave të energjisë.</p> <p>Taksat e Burimeve Natyrore: Taksat e burimeve natyrore përfshijnë taksat për nxjerrjen apo shfrytëzimin e burimeve natyrore (ujë, pyje, kafshë të egra, etj).</p>
3.5. Njësia statistikore	Të dhënrat i referohen taksave mjedisore të mbledhura nga qeveria dhe të pagueshme nga agjentë të ndryshëm ekonomikë.
3.6. Popullata statistikore	Popullsia e synuar janë të gjithë sektorët e prodhimit sipas NVE, familjet si konsumatorë dhe jorezidentët.
3.7. Zona e referencës	Të dhënrat e Taksave Mjedisore janë përfaqësuese në nivel vendi.
3.8. Mbulimi në kohë	<p>Të dhënrat janë të disponueshme nga viti 2008 dhe në vazhdim për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Taksat e Energjisë; • Taksat e Transportit; • Taksat e Ndotjes; • Taksat e Burimeve Natyrore.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Njësia matëse është Milionë Lek (Lek) - Monedha Kombëtare Shqiptarë
5. Periudha e referencës	Periudha e referencës për Taksat Mjedisore është 31 Dhjetor 2019. Ky raport i referohet vitit 2019.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Bazat ligjore në nivel kombëtar ku bazohen Taksat Mjedisore konsiston në: <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" • Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021 ➤ Bazat ligjore në nivel Evropian konsiston në: <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren (KE) Nr. 691/2011 (Shtojca II) për llogaritë ekonomike mjedisore Evropiane të ndryshuar nga Rregullorja 538/2014, si dhe aktet ligjore në fushën e llogarive kombëtare; <ul style="list-style-type: none"> • ESA2010 - Sistemi Evropian i Llogarive 2010; • Shtojca B të Rregullores (BE) Nr. 549/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 21 majit 2013 mbi sistemin evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Bashkimin Evropian; • Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 995/2001 e 22 maj 2001 për zbatimin e Rregullores së Këshillit dhe Parlamentit Evropian (KE) Nr. 2516/2000 të datës 10 korrik 2000 mbi regjistrimin e taksave dhe kontributeve

	shoqërore.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	INSTAT ka filluar transmetimin e të dhënave në Eurostat për herë të parë në 05 Totor 2017, duke mbuluar serinë kohore 2008-2016.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabelë përbledhëse të tillë që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos janë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpérndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesi tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpérndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpérndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p> <p>Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura në njësinë statistikore për prodhimin e statistikave zyrtare përdoren vetëm për qëllime statistikore. Këto të dhëna publikohen së bashku dhe nuk përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, përfshirë vendimet për kontrollin fiskal ose hetimet ligjore.</p>

8. Politika e botimit

8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet për shpërndarjen e statistikave publikohen në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-shpallur në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesi në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesi i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëherëshme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individi për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: <ol style="list-style-type: none">1. Njoftimi për shtyp;2. Kërkesat e shkruara;3. Publikimet specifike;4. Seksioni Kërkesa të dhënash.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	Statistikat e Taksave Mjedisore publikohen në baza vjetore.

10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia

10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacione mbi treguesit kryesorë si: taksat e energjisë, taksat e transportit, etj. Formati i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos dhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp për Taksat Mjedisore publikohet online në faqen e internetit të INSTAT: Taksat e Mjedisit në Shqipëri
10.2. Publikime	Rezultatet e Taksave Mjedisore gjenden të botuara në seksionin “Taksat e Mjedisit në Shqipëri”. Përdoruesit mund ti gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT: Taksat e Mjedisit në Shqipëri
10.3. Baza e të dhënavë on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënavë e aksesoni më poshtë: Databaza Statistikore .
10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Të dhënat nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënavë që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 “Për statistikat zyrtare”.

10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologja e Taksave së Mjedisit është e bazuar në manualet dhe rregulloret e Eurostat, i cili përmban një grup të plotë rekomandimesh për përpilimin e treguesve të statistikave të Taksave Mjedisore. Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë mbi Taksat Mjedisore.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi statistikat e Taksave Mjedisore për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin ‘Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standarde shkencore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënrat e Taksave Mjedisore krahasohen me të dhënrat e viteve të mëparshme për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënavë apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha. Në rast ndryshimesh, të dhënrat administrative përdoren për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen ndryshime të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e të dhënavë të Taksave Mjedisore ndahen në përdorues të brendshëm dhe të përdorues të jashtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përdorues të jashtëm <ul style="list-style-type: none"> • Institucionet e administratës publike • Universitetet • Organizata joftimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare • Bizneset • Studiuesit, studentët dhe grupe të tjera të ngjashme. ➤ Përdorues të brendshëm <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare

	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Statistikave Ekonomike • Drejtoria e Statistikave Sociale • Drejtoria e Sektorit Real <p>të cilët përdorin statistikat e taksave mjedisore si input në punën e tyre.</p>						
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me të dhënat e “Llogarive Ekonomike të Mjedisit” për vitin 2020 janë rrëth 1,361 klikime.</p> <p>Gjatë vitit 2020, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Rezultatet e vrojtit të gjetur se cilësia e përgjithshme e temës “Llogaritë Ekonomike të Mjedisit” është vlerësuar me 3.53 (70.6%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) deri në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>						
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënavë mbi “Taksat Mjedisore” gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura. Shkalla e Plotshmërisë të të dhënavë të “Taksat Mjedisore” për 2019 është 50%.</p>						
13. Saktësia dhe besueshmëria							
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënavë. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton institucionet përkatëse dhe sektorët brenda INSTAT për të vënë në dijeni rrëth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigimi i këtyre të dhënavë nëse shihet i nevojshëm. Saktësia e përgjithshme konsiderohet e mirë.</p>						
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.</p>						
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Rishikimi i të dhënavë ndodh vetëm nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt azhurnimi ose ndonjë gabim të mundshëm njerëzor. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë publikimi më i fundit do të pasqyrojë këto ndryshime dhe do të sigurojë informacion të shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet jo të kampionimit trajtohen bazuar në politikën e Trajimit të Gabimeve.</p>						
14. Afatet kohore dhe përpikmëria							
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Statistikave për Taksat Mjedisore publikohen në faqen e internetit të INSTAT 563 ditë pas përfundimit të periudhës referuese ($T + 563$ ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave për Taksat Mjedisore është data 31 Dhjetor 2019.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2019</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>7/16/2021</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>563</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2019	Data e publikimit	7/16/2021	Afatet kohore	563
Periudha referuese	12/31/2019						
Data e publikimit	7/16/2021						
Afatet kohore	563						

14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënrat për Taksat Mjedisore publikohen në kalendarin e publikimeve. Publikimi për Taksat Mjedisore ka qenë i përpiktë në kohë në 100% të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="446 265 886 411"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2019</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>7/16/2021</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>7/16/2021</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2019	Data e shpallur	7/16/2021	Data e publikimit	7/16/2021	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2019								
Data e shpallur	7/16/2021								
Data e publikimit	7/16/2021								
Vonesa në kohë	0								

15. Koheranca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Mbulimi i të dhënave për Taksat Mjedisore është gjithëpërfshirës në nivel vendi, të dhënrat janë administrative dhe informacioni statistikor është gjithmonë i disponueshëm.</p> <p>Të dhënrat për Taksat Mjedisore përpilohen në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Eurostat dhe janë të krahasueshme me të gjithë vendet europiane që raportojnë të dhënrat e Taksave Mjedisore në Eurostat.</p>
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Të dhënrat mbi Taksat Mjedisore datojnë që nga viti 2008 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 12 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=12).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontolle të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
15.3. Koheranca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koheranca e brendshme	Nuk aplikohet.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave mbi Taksat Mjedisore është: 2 punonjës pranë pranë zyrate qëndrore të INSTAT, në sektorin e Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis.

17. Rishikimi i të dhënave

17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revisionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se autoritetet lokale që dërgojnë informacion në INSTAT mbi Takst e Mjedisit do të raportojnë ndryshime, ky informacion do të azhurnohet dhe publikohet në botimin e muajit pasardhës, shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit.</p>

	<p>Gjatë vitit 2020, INSTAT ka kryer revizionime të klasifikimit të taksave në përputhje me Politikën e revizionimit statistikor. Si rezultat i këtyre revizionimeve u pa e nevojshme të rishikohen të gjitha seritë kohore të Taksave të Mjedisit. Ndryshimet në Taka e Mjedisit kanë ardhur si pasojë e riklasifikimeve të disa taksave si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Klasifikimi i dy prej taksave që ndikojnë mbi mjedisin dhe përfshirja e tyre si pjesë e taksave të ndotjes dhe të burimeve natyrore. 2- Riklasifikimi i një prej taksave që ka ndikim mbi mjedisin, nga Taksë Transporti në Taksë Energjje, e përdorur për qëllime transporti. <p>Këto ndryshime janë reflektuar në të gjithë serinë kohore të taksave mjedisore të publikuar në faqen e INSTAT dhe në databazën statistikore, si dhe shpjegohen në seksionin “Metodologjia” të kësaj faqeje.</p>
--	---

18. Përpunimi statistikor

18.1. Burimi i të dhënavë	Për statistikat mbi “Taksat Mjedisore”, INSTAT përdor informacionin e siguruar nga Memorandumi i Mirëkuptimi ndërmjet INSTAT dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënavë	Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënavë për “Taksat Mjedisore” kryhet në baza vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënavë	<p>Të dhënat për “Taksat Mjedisore” janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i Taksave Mjedisore grumbullohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe më pas, ky informacion i vihet në dispozicion INSTAT në detajimin sipas kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Taksat e energjisë; • Taksat e transportit; • Taksat e ndotjes; • Taksat e burimeve.
18.4. Vlefshmëria e të dhënavë	Janë zbatuar disa rregulla për të analizuar cilësinë e të dhënavë për “Taksat Mjedisore”, të cilat përfshijnë: kontolle logjike dhe matematike. Këto kontolle kryhen gjatë gjithë procesit të përpunimit të të dhënavë, për të gjithë treguesit që INSTAT publikon.
18.5. Përpilimi i të dhënavë	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komente	
Aneks	